L I G J
Nr.7964, datë 19.7.1995

PËR DISA SHTESA E NDRYSHIME NË LIGJIN NR.7810, DATË 6.4.1994 "PËR ARSIMIN E LARTË NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË"

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit 7491 datë 29.4.1991, "Për dispozitat kryesore kushtetuese", propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Në ligjin nr.7810, datë 6.4.1994 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", pas nenit 39 shtohet një kre i veçantë: "Arsimi i lartë ushtarak" me nenet 39/a, 39/b, 39/c, 39/ç, me këtë përmbajtje:

"Neni 39/a

Arsimi i lartë ushtarak kryhet në Akademitë Ushtarake të Oficerëve, ndërsa arsimi i lartë civil i oficerëve kryhet në universitetet e vendit. Arsimi pasuniversitar ushtarak kryhet në Akademinë e Mbrojtjes.

Misioni i arsimit të lartë ushtarak, përveç përcaktimeve të tjera në nenin 1, është:

Të përgatitë oficerë të aftë të gatshëm për një jetë me përkushtim në shërbim e në mbrojtje të atdheut dhe kombit.

Neni 39/b

Akademitë ushtarake të oficerëve varen nga ministrat përkatës.

Përcaktimi i strukturës së çdo akademie ushtarake, numri i studentëve dhe llojet e specialiteteve bëhen në vartësi nga arsimimi që jepet dhe miratohet nga titullari i ministrisë.

Drejtuesit ushtarakë të strukturave të akademive ushtarake të oficerëve emërohen nga titullari i ministrisë ose institucionit përkatës.

Neni 39/c

Statutet dhe rregulloret e brendshme të akademive ushtarake miratohen nga ministri përkatës, ndërsa planet dhe programet mësimore të tyre miratohen nga komandantët e akademive.

Përcaktimi i normave mësimore shkencore të personelit drejtues në akademitë ushtarake bëhet me miratimin e ministrit përkatës, në bazë të propozimeve të akademive ushtarake, duke qënë të përafërta me ato të shkollave të larta të vendit.

Buxheti i akademive ushtarake është një zë më vete në buxhetin e ministrave përkatëse.

Neni 39/ç

Përveç përcaktimeve të neneve 34 dhe 39 kur kandidati merret pas përfundimit të një shkolle të lartë civile, koha e studimeve në akademinë ushtarake është jo më pak se 1 (një) vit.

Për oficerët që nuk kanë marrë arsimin universitar civil, arsimi me ose pa shkëputje nga puna në një degë të universiteteve civile është pjesë e arsimimit të tyre që do të kryhet në përputhje me kriteret e përcaktuara nga ky ligj dhe u garantohet falas nga shteti."

Neni 2

Të gjitha dispozitat që bien në kundërshtim me këtë ligj, shfuqizohen.

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.1163, datë 31.7.1995 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha